

KLSH merr pjesë në takimin e mbajtur në Tiranë në kuadër të Auditimit të Përbashkët të Performancës me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”.

Në vijim të angazhimit që KLSH ka ndërmarrë së bashku me SAI-t e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe në bashkëpunim me UN Women Albania për të kryer auditimin e përbashkët me temë, “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, në datat 21-22 Shkurt 2024, u zhvillua në Tiranë takimi rajonal ku morën pjesë grupet e auditimit të secilit SAI, si dhe përfaqësues të UN Women nga vendet pjesë e këtij projekti.

Takimi u organizua nga UN Women dhe objektivi kryesor i tij ishte diskutimi i raporteve përfundimtare të secilit SAI dhe Raporti i Përbashkët i cili do të publikohet në muajin Prill 2024. Në këtë takim KLSH u përfaqësua nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës z. Alfred Zylfi dhe nga grupi i auditimit, znj. Ermira Vojka, përgjegjëse grupi, znj. Arminda Bushi, dhe znj. Jorida Zhegu anëtare.

Secili grup prezantoi rezultatet përfundimtare të auditimit në vendet e tyre. Pas prezantimeve përkatëse, u diskutua rreth Raportit të Përbashkët si dhe mënyrat e publikimit të rezultateve të auditimit. Në diskutime u përfshinë edhe ekspertët e UN Women të cilët dhanë sugjerimet e tyre lidhur me Raportin e Përbashkët dhe prezantimin e rezultateve.



Foto: UN Women Albania

Në përfundim, grupet e auditimit dhe pjesëmarrësit u dakordësuan për detyrat dhe angazhimet e secilit deri në publikim të Raportit të Përbashkët.